



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____ . _____ .2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data 02.08.2024

Drejtuar: "ALSTEZO" sh.p.k. me NIPT J63208420N

Adresa: Qendër: Lagjia Kryengritja e Fierit, Rruga Aulona Fier.

Procedura e prokurimit/lotit: "Procedurë e hapur, e thjeshtuar", Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt "Riparim dhe mirëmbajtje automjesh për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë" dhe fond limit 5,997,300 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind) lekë, pa TVSH.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-11922-07-03-2024**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike NR. 35 DATË 08.07.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "ALSTEZO" sh.p.k. me NIPT J63208420N dhe ofertë ekonomike me vlerë 4,497,975 (katër milionë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;
2. Operatori ekonomik "KADIU" sh.a., me NIPT J61817045K dhe ofertë ekonomike me vlerë 4,231,391 (katër milionë e dyqind e tridhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik "KADIU" sh.a., me NIPT J61817045K dhe ofertë ekonomike me vlerë 4,231,391 (katër milionë e dyqind e tridhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH, për arsyet si vijon:

Në vijim, në zbatim të pikës 4, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar Komisioni verifikoi sipas formulës së përcaktuar në dokumentet e tenderit, në qoftë se ofertat e vlefshme/kualifikuara janë anomalisht të ulëta, konkretisht kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlogaritur.

Zm = 75 % e Fondit limit = 75% e 5,997,300 = 4,497,975 lekë pa TVSH.

Nga përlogaritja rezultoi se oferta ekonomike me vlerë 4,231,391 (katër milionë e dyqind e tridhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH, paraqitur nga operatori ekonomik "KADIU" sh.a., me NIPT J61817045K është anomalisht të ulëta.

Në këto kushte, referuar në parashikimet e pikës 5, të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 të ndryshuar, cituar:

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët,

Oferta e paraqitur nga OE "KADIU" sh.a., me NIPT J61817045K do të refuzohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik "ALSTEZO" sh.p.k. me NIPT J63208420N, Adresa: Qendër: Lagjia Kryengritja e Fierit, Rruga Aulona, Fier, oferta e paraqitur me vlerë totale prej 4,497,975 (katër milionë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh, është identifikuar si fitues i procedurës së prokurimit.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JOx

TITULLARI I OPERATORIT TË BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

ADMINISTRATOR

Arlinda POGAJ